

VARIANTET:

- Udhëheqja e bisedës nga N mund të merret edhe nga dy N.
- Duhet që të gjithë N të kenë mundësinë që të marrin përsipër njëherë udhëheqjen e bisedës. Natyrisht për këtë janë të nevojshme disa biseda. Është e mundshme që pas 5–10 minutash roli të jepet më tutje.
- Udhëheqja e bisedës nga N mund të ushtrohet dhe zbatohet edhe në formën e këshillit të klasës etj.

16

Planifikimi i bisedës

Qëllimi

Gjatë planifikimit të bisedës N i ushtrojnë aftësitë e tyre në gjuhën e parë dhe të kuptuarit e asaj që kanë dëgjuar. Njëkohësisht e thellojnë pavarësinë dhe kompetencën sociale nëpërmjet asaj që, në mënyrë demokratike, i bisedojnë marrëveshjet dhe rregullat e qarta për përgjegjësitë, afatet etj. në lidhje me një projekt.

kl. 4–6

30–45 min.



Udhëzim:

Parakusht për këtë ushtrim është që N (ose një grup i tyre) të kenë kohë dhe një temë për një projekt. Këtu mund të bëhet fjalë për çështje të vogla (p.sh. përgatitja e pllakateve për aspektet e ndryshme të vendit të preardhjes në grupe 3-she ose 4-she), ose për projekte të mesme (p.sh. Përgatitja e një referati për një temë nga historia ose gjeografia ose përgatitja për një recitim) ose për projekte të mëdha (koncepti për një libër ose një CD me tekste nga gjuha e preardhjes; përgatitja e një feste ose e një mbrëmjeje me prindër me pjesë teatrore, koktej etj.). Është me rëndësi që të përcaktohet koha dhe kufizimet e përmbajtjes, ashtu që N të mund të punojnë mundësisht në mënyrë të pavarur.

Rrjedha:

- N e përcaktojnë qëllimin e projektit: «Çfarë duam të arrijmë bashkërisht?»
- N grumbullojnë ide: «Si mund t'i zbatojmë qëllimet tona në mënyrë optimale?»
- Idetë do të diskutohen në grupe ose me tërë klasën. Pyetjet fthilluese: «Cilat ide dhe qëllime mund t'i zbatojmë? Kush mund të drejtojë?»
- Në përfundim do të bëhet një plan me shkrim: «Kush bën, çka, si, kur, me kë?»

Vërejtje:

- Biseda për planifikimin, herën e parë do të udhëhiqet nga M. Pastaj udhëheqja e bisedës dhe rolet (p.sh. protokolluesi/ja) mund të merren përsipër nga N (krahaso këtu nr. 14. më lart). M vëzhgon dhe ndërhyr vetëm në raste të jashtëzakonshme.
- Pasi që rrjedha, nocionet kryesore (në gjuhën e parë!) dhe eventualisht pika të tjera të rëndësishme organizative të jenë shënuar në një letër, kjo i ndihmon N që të orientohen në bisedë dhe pastaj në punë.